



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2254, datë 23.01.2013

Për

**Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren
Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z.	Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z.	Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.	Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z.	Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj.	Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.01.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren
Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”.**

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja t) e nenit 8, pika 1 e nenit 114 dhe neni 115 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr.9918**);
2. Neni 120 dhe neni 129 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**KPrA**), i ndryshuar;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.370, datë 5.6.2003 Për miratimin e strategjisë “Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë” (**VKM 370**).
4. Pika 2 e nenit 15 te Rregullores Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar” (**Rregullore Nr. 6**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr. 522, datë 23.12.2008.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Projekt-Dokumenti rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”;

si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, me qëllim përmbushjen sa më të plotë dhe eficiente të detyrimeve ligjore që duhet të zbatojnë subjektet e interesuara, për t'u pajisur me “Çertifikatë Operatori Radiodetar”, çmon si të rëndësishme ndryshimet dhe shtesat në aktin Rregullor Nr. 6 datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për t'u pajisur me licencë nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
2. Grupi i punës i caktuar me Urdhërin nr. 900, datë 30.10.2012 ka hartuar ndryshimet dhe shtesat në projekt aktin administrativ Rregullor Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për t'u pajisur nga AKEP me certifikatë;
3. Ndryshimet dhe shtesat për përcaktimin e rregullave procedurale në Rregulloren Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”, janë mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullor në fuqi si dhe rekomandimeve të ITU-së, duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullatore të AKEP;
4. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në Rregulloren Nr.6 nga Grupi i Punës, për t'u zbatuar nga subjektet e interesuara për certifikatë, nëpërmjet modulit të aplikimeve online, bëhen pa ndryshuar përmbajtjen, objektin, qëllimin dhe kërkesat e përfshira në këte rregullore si dhe me qëllim përmiresimi për:
 - Kalimin e aplikimit për “Çertifikatë Operatori Radiodetar” nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
 - Realizimin e procedurës së paisjes me certifikatë në një kohë sa më të shkurtër, në një mënyrë me të thjeshtuar me rregulla praktike;
 - Shkurtimin e procedurave të përpunimit të dokumentacionit në AKEP duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj subjekteve;
 - Realizimin e një procesi transparent në kufijtë e veprimit të Autoritetit Publik;
5. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, në kuadër të transparencës dhe paanësisë çmon si të arsyeshme miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për certifikatë, të projekt aktit administrativ Rregullor Nr. 6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Çertifikates Operatorit Radiodetar”

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të këtij projekt akti administrativ, për subjektet e interesuara për pajisjen me “Çertifikatë Operatori Radiodetar”, bazuar në shkronjen t) të nenit 8, pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në “Rregullore Nr. 6, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar” sipas Aneksit 1 bashkelidhur;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga data e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

**I. Ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr.6, datë 23.12.2008,
“Për dhënien e Çertifikatës Operatorit Radiodetar”.**
(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.522, datë 23.12.2008).

A. Pika 1 a) e nenit 3, ndryshon dhe bëhet:

**Neni 3
Baza ligjore**

1. AKEP, nxjerr këtë rregullore në mbështetje të:
 - a) Germës p) dhe t) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918) i ndryshuar;

B. Pika 4 e nenit 5, ndryshon dhe bëhet:

**Neni 5
Kriteret e marrjes së Çertifikatës të Operatorit Radiodetar.**

4. Të ketë mbaruar Shkollën e Lartë të Marinës/Navale ose kursin e plotë të trajnimit GMDSS (Global Maritime Distress & Safety System) në përputhje me STCW 95.

C. Pika 1 dhe pika 2 e nenit 6, ndryshojnë dhe bëhen:

**Neni 6
Formulari i aplikimit**

1. Personi që kërkon të pajiset me çertifikatën e operatorit radiodetar duhet të aplikojë online sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, i cili duhet të shoqërohet me deklaratën personale të personit dhe dy copë fotografi (4x6 cm).
2. *Formulari i aplikimit online plotësohet tek Moduli i Aplikimit Online “Për certifikatë të operatorit radiodetar” në faqen web të AKEP www.akep.al.*

D. Shtohet pika 6 dhe pikat 1, 2, 3 e nenit 7, ndryshojnë dhe bëhen:

**Neni 7
Dhënia e Çertifikatës**

1. Çertifikata i jepet aplikuesit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që ka depozituar në AKEP formularin e aplikimit online të plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe pasi të ketë kryer pagesën përkatëse për marrjen e çertifikatës.

2. Kur AKEP konstaton parregullsi në plotësimin e formularit të aplikimit të dërguar online, i kërkon aplikuesit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh pas marrjes së njoftimit online për parregullsitë e konstatuara.
3. Trajtimi i kërkesës online bëhet nga Drejtoria përkatëse në AKEP dhe Çertifikata lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.
6. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes Çertifikatës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP.

E. Pika 2 e nenit 8, ndryshon dhe bëhet:

Neni 8 **Vlefshmëria e certifikatës dhe rinovimi**

1. Çertifikata e operatorit radiodetar është e vlefshme për një periudhe 3 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë rinovimi.
2. Për rinovimin e certifikatës, aplikanti i drejtohet AKEP duke dërguar online kërkesën 15 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së saj.

F. Pika 3 e nenit 8, shfuqizohet:

G. Pika 1 e nenit 9, ndryshon dhe bëhet:

Neni 9 **Detyrimet Financiare**

1. Aplikuesi, me marrjen e njoftimit online nga AKEP për miratimin e certifikatës së kërkuar, është i detyruar që të paguajë detyrimet financiare të parashikuara për licensën në përputhje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara nga AKEP.

H. Germa a) e pikes1 të nenit 12, ndryshon dhe bëhet:

Neni 12 **Aplikimi për testim**

1. Për marrjen e Çertifikatës së Operatorit Radiodetar aplikanti duhet t'i nënshtrohet procedurës së testimit në AKEP në përputhje me këto kërkesa:
a) paraqitja e kërkesës online shoqëruar me dokumentet e kërkuara,

I. Në Aneksin 1 – Formulari i aplikimit online, me qëllim përshtatjen me kërkesat e modulit online për të pajisur aplikantin me “përdorues”, “fjalëkalim” dhe “kod konfirmimi”, tek të dhënat e subjektit është ndryshuar:

“Dokumenti i Identifikimit” ndryshon dhe bëhet “Numri personal sipas dokumentit të identifikimit – ID”.